



Buletini Ekonomik, Tremujori i Katërt i Vitit 2024

ODA EKONOMIKE E KOSOVËS

Shkurt 2025

Përmbajtja

Rreth Nesh	3
Pasqyra e Ekonomisë së Kosovës	3
Statistikat tregtare	4
Tregtia e jashtme e mallrave eksporti-importi, 2021 - 2024	4
Eksportet e Mallrave	5
Eksportet me vendet e BE-së 27	5
Eksportet me vendet e CEFTA	7
Eksportet me vendet tjera të botës	8
Importet e mallrave	9
Importet me vendet e BE 27	9
Importet me vendet e CEFTA	11
Importet me vendet e tjera të botës	12
Inflacioni mujor dhe vjetor	13
Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	13
Ndryshimet e çmimeve për grupet dhe nëngrupet	15
Numri i ndërmarrjeve të regjistruara	17
Numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve sipas aktivitetit	18
Aktivitetet e Kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës	22
Aktivitetet e tjera të Odës Ekonomike të Kosovës	43

Rreth Nesh

Oda Ekonomike e Kosovës është organizatë profesionale e themeluar në vitin 1962 nga Kuvendi i Kosovës.

OEK-u është organizatë profesionale, e pavarur, jopolitike dhe jo-fitimprurëse. Është përfaqësuese legjitime e interesave të komunitetit të biznesit në Kosovë. Është burim i besueshëm i informatave për ndërmarrjet kosovare si dhe për ndërlidhjen me partner ndërkombëtar, analizon gjendjen ekonomike të Kosovës dhe aktivisht propozon forma të reja dhe të avancuara të biznesit vendor dhe bën ndërkombëtarizimin e ndërmarrësisë kosovare. Ka shtrirje në të gjitha rajonet kryesore të Kosovës.


Pasqyra e Ekonomisë së Kosovës

BPV-ja në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënon rritje reale për 4,05% krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak.

Aktivitetet ekonomike që kishin rritje në këtë tremujor janë: Industria përpunuese 5,30%; Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit 4,60%; Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse 3,78%; Ndërtimtaria 3,60%; Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera 3,30%; Informacioni dhe komunikimi 2,84%; Bujqësia, pyjet dhe peshkimi 2,24%; Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor 3,15%; Aktivitetet financiare dhe të sigurimit 1,22%; Aktivitete të pasurive të paluajtshme 0,76% dhe Administrata publike 0.74%.

Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve që kishin rritje janë: Eksporti i mallrave dhe shërbimeve 9,62%; Importi i mallrave dhe shërbimeve 9,23%; Formimi i bruto kapitalit 7,62% Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH 3,24% dhe Shpenzimet e konsumit final të qeverisë 2.38%.

Rritja reale e BPV-së tremujore në %, krahasuar me periudhën përkatëse të vitit paraprak




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Statistikat tregtare

Tregtia e jashtme e mallrave eksporti-importi, 2021 - 2024

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), për periudhën janar - dhjetor 2024 tregojnë një rritje të deficit tregtar prej 6.8% në raport me periudhën e njëjtët të vitit 2023, gjegjësisht deficitin tregtar i mallrave arrin vlerën prej -5,391.6 milion euro krahasuar me deficitin -5,049.7 milion euro sa ishte në vitin 2023. Eksporti mbulon importin me 14.9%.

Bilanci tregtar i mallrave në mil.Euro




Tregtia e jashtme e mallrave sipas viteve (miliona €) dhe përqindja e mbulimit, tabela në vijim:

Viti	2021	2022	2023	2024
Eksport	755.7	920.4	863.1	941.3
Import	4,684.2	5,639.4	5,912.8	6,332.9
Bilanci tregtar	(3,928.5)	(4,719.0)	(5,049.7)	(5,391.6)
% e mbulimit	16.1	16.3	14.6	14.9

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Eksporti i mallrave në 2024 arrin vlerën 941.3 milion euro, që është një rritje prej 9.1% për eksport krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Sipas të dhënave të grupeve kryesor të eksportit e përbëjnë: 22.0% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 17.5% Produktet Minerale, 10.7% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 10.4% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10.1% Artikuj të ndryshëm të prodhuar; 5.4% Tekstilet dhe Artikujt Tekstile, etj.

Importi i mallrave në 2024 arrin vlerën 6,332.9 milion euro, që është një rritje prej 7.1% të importit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Sipas të dhënave të grupeve kryesor për import e përbëjnë: 14.1%; Produktet minerale; 12.2% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 12.3% Makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 11.7% Mjetet e transportit; 9.9% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 7.5% Produkte të industrisë kimike etj.




Eksportet e Mallrave

Eksportet me vendet e BE-së 27

Në periudhën janar – dhjetor 2024 eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 294.0 milion euro, ose rreth 29.7% të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 5.5% krahasuar me periudhën e vitit paraprak.

Eksportet në vendet e BE 27, 2023/2024 në mil.Euro



Partneret kryesor për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania me 9.4%, Italia me 3.5%, Austria 2.3%, Franca 1.9%, Sllovenia 1.8%, Belgjika me 1.4%, etj., si pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm.


Eksportet në vendet e BE 27 sipas viteve (miliona €) dhe përqindja si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm, tabela në vijim:

EXPORTE në vendet BE 27	2021		2022		2023		2024	
	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %
Gjermania	61.3	8.2%	87.8	9.5%	93.6	10.8%	92.7	9.4%
Italia	59.7	8.0%	46.4	5.0%	38.7	4.5%	35.1	3.5%
Austria	10.3	1.4%	15.5	1.7%	20.2	2.3%	23.0	2.3%
Franca	10.4	1.4%	14.3	1.6%	16.2	1.9%	18.9	1.9%
Belgjika	10.4	1.4%	16.0	1.7%	17.0	2.0%	16.3	1.6%
Bullgaria	16.6	2.2%	12.7	1.4%	9.9	1.2%	14.3	1.4%
Spanja	5.3	0.7%	1.7	0.2%	5.7	0.7%	12.9	1.3%
Holanda	20.5	2.7%	29.1	3.2%	27.2	3.2%	13.6	1.4%
Kroacia	6.3	0.8%	10.0	1.1%	9.1	1.1%	12.1	1.2%
Suedia	5.4	0.7%	4.9	0.5%	5.5	0.6%	7.1	0.7%
Slovenia	9.4	1.3%	29.7	3.2%	3.5	0.4%	18.3	1.8%
Rumania	2.0	0.3%	3.3	0.4%	4.6	0.5%	6.0	0.6%
Greqia	4.1	0.6%	5.0	0.5%	6.4	0.7%	6.5	0.7%
Tjera të BEsë	13.2	1.8%	35.5	3.9%	21.0	2.4%	17.3	1.7%
Gjithsej	235.1	31.4%	311.8	33.9%	278.6	32.3%	294.0	29.7%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Eksportet me vendet e CEFTA

Në periudhën janar-dhjetor 2024, eksportet e Kosovës me vendet CEFTA-së arritën në 425.9 milion euro, ose 45.2% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 23.9% krahasuar me periudhën e vitit paraprak. Partner kryesor për eksport nga vendet e CEFTA-së janë: Shqipëria me 18.1%, me Maqedonia e Veriut me 15.3%, Serbia me 5.7% dhe Mali i zi me 4.7%, B&H me 1.5%, si pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm.




Tregtia me vendete e CEFTA nga viti në vit shënon trend rritës, tablat në vazhdim paraqet eksportet e Kosovës në vendet e CEFTA sipas viteve (milion €) dhe përqindja si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm:

EXPORTE në vendet CEFTA	2021		2022		2023		2024	
	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>
Shqipëria	110.5	14.7%	102.0	11.1%	114.9	13.3%	170.0	18.1%
Maqedonia e Veriut	86.6	11.6%	119.1	12.9%	121.6	14.1%	144.0	15.3%
Serbia	43.9	5.9%	62.9	6.8%	49.6	5.8%	53.3	5.7%
Mali i Zi	24.5	3.3%	38.3	4.2%	45.0	5.2%	44.5	4.7%
Bosnia dhe Herzegovina	11.2	1.5%	11.4	1.2%	12.4	1.4%	13.9	1.5%
Moldavi	0.0	0.0%	0.0	0.0%	0.1	0.0%	0.3	0.0%
Gjithsej	276.8	36.9%	333.6	36.2%	343.6	39.8%	425.9	45.2%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Eksportet me vendet tjera të botës


Në periudhën janar-dhjetor 2024, eksportet e Kosovës me vendet tjera (jashtë BE 27 dhe CEFTA) arritën në 221.3 milion euro, ose 25.1% të eksporteve të përgjithshme. Si partner më të rëndësishëm nga këto vendet për eksport vlen të përmendën: Zvicra me 9.2%, SHBA me 4.2% dhe Turqia me 2.9%.



Eksporti i përgjithshëm i mallrave sipas viteve (miliona €) dhe përqindja si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm, tabela në vijim:

EXPORTE	2021		2022		2023		2024	
	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>
CEFTA	276.8	36.9%	333.6	36.2%	343.6	39.8%	425.9	45.2%
BE 27	235.1	31.4%	311.8	33.9%	278.6	32.3%	294.0	29.7%
ZVICER	56.0	7.5%	70.1	7.6%	75.6	8.8%	86.3	9.2%
SHBA	122.6	16.4%	136.5	14.8%	106.3	12.3%	39.6	4.2%
TURQI	17.4	2.3%	23.5	2.5%	20.2	2.3%	27.5	2.9%
Tjera	41.8	5.6%	45.0	4.9%	38.7	4.5%	67.9	8.8%
Gjithsej	749.7	100.0%	920.4	100.0%	863.1	100.0%	941.3	100.0%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)




Gjatë viteve 2021 - 2024, janë eksportuar mesatarisht me rreth 39.6% për në vendet e CEFTA-së, dhe 31.8% në vendet e BE së, pjesa tjetër për në Zvicra 8.3%, SHBA me 11.9%, Turqia me 2.5% dhe Tjera 5.9% si përqindje e eksporteve të përgjithshme.

Importet e mallrave

Importet me vendet e BE 27

Gjatë vitit 2024 importet e Kosovës nga vendet e BE-së arritën në 2,836.7 milion euro, ose rreth 44.8% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 23.0% krahasuar me periudhën e vitit paraprak.

Importet nga vendet e BE 27, 2023/2024 në mil.Euro



Partneret kryesor të importit të mallrave në BE janë: Gjermania me 14.1%, Italia me 5.2%, Greqia me 5.0%, Polonia me 3.3%, Bullgaria 2.1%, Kroacia me 2.1%, Sllovenia 1.9% etj., si pjesëmarrjen në importin e përgjithshëm.


Importet nga vendet e BE 27 sipas viteve (miliona €) dhe përqindja si pjesëmarrjen në importin e përgjithshëm, tabela në vijim.

IMPORTE nga vendet BE 27	2021		2022		2023		2024	
	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %
Gjermania	606.6	13.0%	610.4	10.8%	682.6	12.6%	890.5	14.1%
Italia	275.1	5.9%	275.9	4.9%	287.5	5.3%	330.9	5.2%
Greqia	204.2	4.4%	307.3	5.5%	301.2	5.5%	315.4	5.0%
Polonia	131.5	2.8%	135.1	2.4%	140.4	2.6%	208.6	3.3%
Bullgaria	80.2	1.7%	94.3	1.7%	88.1	1.6%	131.9	2.1%
Kroacia	93.3	2.0%	102.2	1.8%	105.1	1.9%	134.6	2.1%
Slovenia	176.6	3.8%	243.6	4.3%	117.7	2.2%	120.7	1.9%
Hungaria	66.0	1.4%	86.2	1.5%	73.1	1.3%	103.7	1.6%
Austria	71.7	1.5%	84.6	1.5%	81.6	1.5%	99.7	1.6%
Franca	67.4	1.4%	81.6	1.4%	67.9	1.2%	93.9	1.5%
Rumania	51.6	1.1%	64.6	1.1%	73.0	1.3%	85.7	1.4%
Hollanda	51.0	1.1%	48.6	0.9%	45.8	0.8%	59.7	0.9%
Cekia	42.1	0.9%	53.7	1.0%	68.2	1.3%	62.4	1.0%
Spanja	55.4	1.2%	60.3	1.1%	58.3	1.1%	58.6	0.9%
Tjera të BEsë	89.7	1.9%	140.5	2.5%	114.8	2.1%	140.5	2.2%
Gjithsej	2,062.2	44.3%	2,388.8	42.4%	2,305.4	42.4%	2,836.7	44.8%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Importet me vendet e CEFTA

Në periudhën janar-dhjetor 2024, importet e Kosovës nga vendet CEFTA-së arritën në 851.5 milion euro, ose 13.4% të importeve të përgjithshme, kjo paraqet një rënje prej -3.8% me pakë krahasuar me periudhën e vitit paraprak.



Partner kryesor te importi i mallrave nga vendet e CEFTA-së janë: Shqipëria me 5.3%, me Maqedonia e Veriut me 4.7%, dhe Serbia me 2.0%, si pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm.


Me shumë detal mbi trendin e importeve nga vendet CEFTA sipas viteve (milion €) dhe përqindja si pjesëmarrjen në importin e përgjithshëm, tabela në vijim.

IMPORTE nga vendet CEFTA	2021		2022		2023		2024	
	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %
Shqipëria	264.6	5.7%	255.9	4.5%	310.9	5.7%	338.2	5.3%
Maqedonia e Veriut	241.5	5.2%	282.1	5.0%	294.9	5.4%	297.7	4.7%
Serbia	304.6	6.5%	372.1	6.6%	192.7	3.5%	129.7	2.0%
Mali i Zi	25.1	0.5%	24.1	0.4%	28.6	0.5%	25.9	0.4%
Bosnia dhe Hercegovina	50.9	1.1%	66.1	1.2%	57.3	1.1%	58.7	0.9%
Moldavi	0.3	0.0%	0.5	0.0%	0.7	0.0%	1.2	0.0%
Gjithsej	886.9	19.1%	1,000.7	17.7%	885.2	16.3%	851.5	13.4%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Importet me vendet e tjera të botës

Në periudhën janar-dhjetor 2024, importet e Kosovës me vendet tjera (jashtë BE 27 dhe CEFTA) arritën në 2,644.7 milion euro, ose 41.8% të importeve të përgjithshme.




Si partner më të rëndësishëm, te importin nga vendet tjera janë: Turqia me 14.3%, Kina me 11.9% dhe SHBA me 1.7%.

Tablat në vazhdim paraqet Importet e Kosovës nga CEFTA; BE27 dhe Vendet tjera sipas viteve (miliona €) dhe përqindja si pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm:

IMPORTE	2021		2022		2023		2024	
	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>
CEFTA	886.9	19.1%	1,000.7	17.7%	885.2	16.3%	851.5	13.4%
BE 27	2,062.2	44.3%	2,388.8	42.4%	2,305.4	42.4%	2,836.7	44.8%
Turqia	584.1	12.6%	843.0	14.9%	796.6	14.6%	905.2	14.3%
Kina	449.3	9.7%	548.6	9.7%	594.0	10.9%	756.2	11.9%
SHBA	92.9	2.0%	71.9	1.3%	86.3	1.6%	106.7	1.7%
Zvicër	31.3	0.7%	40.7	0.7%	38.9	0.7%	40.6	0.6%
Tjera	546.0	11.7%	745.7	13.2%	731.1	13.4%	836.1	13.2%
Gjithsej	4,652.7	100.0%	5,639.4	100.0%	5,437.4	100.0%	6,332.9	100.0%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)



Gjatë viteve 2021-2024, janë importuar mesatarisht me rreth 16.6% nga vendet e CEFTA-së, dhe 43.5% nga vendet e BE së, pjesa tjetër nga vendet si Turqia me 14.1%, Kina me 10.6% dhe SHBA me 1.6%, Zvicra me 0.7%, dhe Tjera 12.9% si përqindje e importeve të përgjithshme.

Inflacioni mujor dhe vjetor

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)


Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), përkatësisht Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) si parametër statistikor, ndryshe njihet edhe si Indeksi i Kostos së Jetesës, gjithashtu merret edhe si parametër për matjen e Inflacionit.

Bazuar në të dhënat e publikuara nga ASK, Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0,7 % në muajin Dhjetor 2024 krahasuar me muajin Nëntor 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: biletat e fluturimeve (25,4%), energjia elektrike (6,2%), perimet (2,5%), kafja, çaji dhe kakao (2,2%) dhe qumështi, djathi dhe vezët (1,3%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,8 për qind në IHÇK-it. Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: pemët (-2,5%) dhe pijet alkoolike (-1,2%) me një ndikim prej -0,1 për qind në IHÇK-it.

Kjo tregon një rritje të lehtë në çmimet me tendencë stabilizimi krahasuar me periudhën e kaluar trevjeçare. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: kafja, çaji dhe kakao (14,4%), vajrat dhe yndyrat (9,3%),


shërbimet financiare (9,1%), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (5,9%), gazetatat, librat dhe materialet për zyra (5,0%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (4,8%), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (4,5%), qumështi, djathi dhe vezët (3,8%), pijet alkoolike (3,5%), veshje (3,0%), mishi (2,9%), kujdesi personal (2,7%), buka dhe drithërat (2,6%), sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat (2,5%), prodhimet ushqimore (1,8%), shërbimet hoteliere (1,8%), veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht (1,6%), duhani (1,4%), pajisje shtëpiake (1,2%) dhe perimet (1,0%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2,0 për qind në IHÇK-it. Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (- 8,3%), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-5,7%), pemët (-4,1%), blerja e automjeteve (-2,5%) dhe energjia elektrike (-2,2%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,9 për qind në IHÇK-it.

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit në vend në vitin 2024 ishte më i lartë në një mesatare prej (1,6 %) krahasuar me vitin 2023. Ngritja e indeksit të çmimeve të konsumit është vërejtur te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: biletat e fluturimeve (10,8%), kafja, çaji dhe kakao (8,0%), pijet alkoolike (6,9%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (6,5%), shërbimet financiare (5,8%), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (5,3%), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (5,2%), sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat (5,1%), pemët (4,8%), gazetatat, librat dhe materialet për zyra (4,6%), veshje (4,0%), kujdesi personal (3,7%), energjia elektrike (3,4%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (3,3%), duhani (2,7%), buka dhe drithërat (2,5%), shërbimet hoteliere (2,0%) dhe mishi (1,9%) me një ndikim të përbashkët prej 2,0 për qind në IHÇK-it. Rënie e indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit gjatë vitit 2024 është vërejtur te nëngrupet e COICOP-it: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-4,4%) dhe blerja e automjeteve (-1,8%) me një ndikim të përbashkët prej -0,4 për qind në IHÇK-it. Në vazhdim është paraqitja grafike e normave mujore dhe vjetore të inflacionit në % të matura nga IHÇK.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Në figurën, janë paraqitur ndryshimet e çmimeve të konsumit në baza mujore gjatë periudhës janar 2020 - 2024. Norma vjetore e inflacionit në % të matura nga IHÇK.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Në figurë, janë paraqitur ndryshimet e çmimeve të konsumit në baza vjetore 2020 - 2024 dhe një parallogaritje për periudhës janar dhjetor 2024, nga të dhënat e disponushme nga Agjencia e Statistikave.

Ndryshimet e çmimeve për grupet dhe nëngrupet

Peshat për grupe dhe nëngrupet dhe ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it.

COICOP Grupe dhe nëngrupet	Pesha 2024 në %	XII-2024 2015=100	XII-2024 XI-2024	XII-2024 XII-2023	Indeksi mesatar vjetor 2024 2015=100	2024 2023
00. IHÇK total	1,000.00	131.2	0.7%	1.1%	130.1	1.1%
01. Ushqime dhe pije joalkoolike	351.1	148.2	0.7%	3.5%	145.3	2.2%
02. Pije alkoolike, duhan	67.6	141.7	-0.3%	2.1%	140.7	4.1%
03. Veshje dhe këpucë	40.6	109.8	0.2%	2.2%	108.8	2.9%
04. Banesa, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera	89.8	125.1	1.9%	-3.1%	123.6	2.7%
05. Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinë të shtëpisë	63.3	124	0.5%	2.6%	122.5	2.9%
06. Shëndeti	22.8	117.1	0.6%	0.6%	120.5	1.2%
07. Transporti	176.7	118.6	1.7%	-2.9%	120.5	-2.0%
08. Komunikimi	23.7	112.3	0.1%	-1.9%	113.7	-0.7%
09. Rekreacion dhe kulturë	44.5	107.6	0.0%	1.4%	106.9	3.1%
10. Arsimi	6.9	104.2	0.0%	0.2%	104.1	-0.5%
11. Restorante dhe hotele	40.8	131.6	0.2%	1.8%	130.3	2.0%
12. Mallra dhe shërbime të ndryshme	72.2	121.4	0.2%	2.3%	119.9	2.3%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Nga tabela mund të shihet se lëvizjet e çmimeve te katër grupe dhe nëngrupe kryesor të artikujve si: **01. Ushqime dhe pije joalkoolike** (me pesha 351.1‰), pasuar nga lëvizja e çmimeve te grupet dhe nëngrupet **07. Transporti** (me pesha 176.7‰), **04. Banesa, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera** (me pesha 89.8‰), dhe **02. Pije alkoolike, duhan** (me pesha 67.6‰), kanë ndikimin përcaktues (*ne rreth 70%*) ndikimit në ndryshimet mujore dhe vjetore.


Tabela në vijim paraqet lëvizjet e çmimeve, Çmimi mesatar në euro për disa artikuj dhe shërbime të konsumit (dhjetor 2023, dhe nëntor - dhjetor 2024).

Kodi	Artikujt	Njësia matëse	XII 2023	XI 2024	XII 2024
101	Oriz	1 kg	1,64	1,69	1,67
102	Miell gruri	1 kg	0,80	0,81	0,81
103	Bukë e bardhë	500 gr	0,51	0,52	0,51
111	Mish gjedhi pa eshtra	1 kg	8,88	8,98	9,02
112	Mish viçi	1 kg	10,15	10,23	10,22
114	Mish pule	1 kg	3,94	4,15	4,11
131	Qumësht (Tetrapak)	1 lit	1,18	1,22	1,23
133	Jogurt	1 lit	1,15	1,21	1,20
137	Vezë	30 copë	3,39	3,04	3,30
141	Vaj ushqimor luledielli	1 lit	1,40	1,48	1,52
151	Mollë	1 kg	0,95	0,94	0,91
152	Dardhë	1 kg	1,93	1,89	1,88
153	Banane	1 kg	1,43	1,38	1,38
155	Limon	1 kg	1,31	1,60	1,50
161	Patate	1 kg	0,81	0,53	0,60
162	Domate	1 kg	1,64	1,85	1,85
163	Fasule	1 kg	3,31	3,62	3,68
167	Speca të pa djegës	1 kg	1,89	2,07	2,14
175	Sheqer	1 kg	1,28	1,24	1,21
192	Kafe e bluar	1 kg	11,28	13,35	13,94
193	Çaj	1 kg	9,08	9,29	9,29
195/1	Uji natyral pa gaz	1.5 lit	0,35	0,37	0,37
196	Coca cola	2 lit	1,46	1,57	1,58
197	Lëng pemësh	1 lit	1,08	1,09	1,08
204	Birrë	0.5 lit	0,82	0,86	0,86
216	Cigare - Ronson	1 pako	2,08	2,09	2,10
217	Cigare - Marlboro	1 pako	3,06	3,09	3,10
416	Energja elektrike (Pa kosto fikse)	1 kwh	0,08	0,07	0,07
418	Dru zjarri	1 m ³	63,22	56,02	55,91
701	Benzin	1 lit	1,29	1,27	1,26
702	Dizel	1 lit	1,34	1,24	1,23

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Numri i ndërmarrjeve të regjistruara

Në periudhën janar-nëntor 2024 gjithsej janë regjistruar 11,108 ndërmarrje të reja (janar deri nëntor 2023, janë regjistruar 10,615 ndërmarrje të reja), ky numër parqet një rritje prej 4.6% krahasuar me periudhën e vitit paraprak, ndërsa trendi i ndërmarrjeve të shuara shënon një rritje të lehtë prej 0.1%.



(*) të dhënat për tm4 deri nëntor 2024

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Aktivitetet ekonomike më të preferuara në regjistrimin e të ndërmarrjeve të reja gjatë periudhës janar nëntor ishin: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 2,728 apo 24.6% regjistrimin të ndërmarrjeve të reja, Prodhim me rreth 1,265 apo 11.4%, Ndërtimtari me 1,233 apo 11.1%, Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 1,093 apo 9.8%, Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 940 apo 8.5%, si përqindje të regjistrimit të ndërmarrjeve të reja etj.

Tablat në vazhdim paraqet ndërmarrje të reja në numër dhe përqindja si pjesëmarrjen në gjithsej ndërmarrje të reja të regjistruara:

Ndërmarrjet e reja sipas viti dhe seksionet e aktiviteteve ekonomike (sipas NACE Rev. 2)	2022		2023		deri nëntor 2024*	
	nr.	%	nr.	%	nr.	%
A Bujqësi, pylltari dhe peshkari	370	3.4	395	3.5	445	4.0
B Xehetari dhe gurëthyes	28	0.3	25	0.2	20	0.2
C Prodhim	1,219	11.1	1,163	10.2	1,267	11.4
D Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	94	0.9	106	0.9	71	0.6
E Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	33	0.3	37	0.3	37	0.3

F Ndërtimtari	1,239	11.2	1,168	10.2	1,233	11.1
G Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	2,598	23.6	2,765	24.2	2,728	24.6
H Transport dhe ruajtje	278	2.5	276	2.4	348	3.1
I Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	1,119	10.2	1,061	9.3	940	8.5
J Informacion dhe komunikim	650	5.9	684	6.0	670	6.0
K Aktivitete financiare dhe sigurimit	82	0.7	106	0.9	92	0.8
L Aktivitete të patundshmërisë	168	1.5	197	1.7	160	1.4
M Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	1,068	9.7	1,211	10.6	1,093	9.8
N Aktivitete administrative dhe mbështetëse	729	6.6	781	6.8	728	6.6
O Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social I detyrueshëm	15	0.1	16	0.1	13	0.1
P Arsimit	131	1.2	157	1.4	119	1.1
Q Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	294	2.7	301	2.6	283	2.5
R Art, zbavitje dhe rekreacion	245	2.2	222	1.9	247	2.2
S Aktivitete të shërbimeve tjera	664	6.0	751	6.6	614	5.5
Gjithsej	11,024	100.0	11,422	100.0	11,108	100.0

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Ndërmarrjet e reja kryesisht janë regjistruar në kategorinë “Mikro Ndërmarrje” (1 deri në 9 të punësuar) me rreth 99%, në kategorinë “Ndërmarrje të Vogla” (10 deri 49 të punësuar) janë rreth 1% ndërmarrje të regjistruara, kurse në kategoritë “Ndërmarrje të Mesme” (50 deri 249 të punësuar) dhe “Ndërmarrje të Mëdha” (mbi 250 të punësuar) nuk kemi ndërmarrje të regjistruara në këtë periudhë.

Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të regjioneve: Regjioni i Prishtinës prinë me mbi 45% ndërmarrje të regjistruara, Regjioni i Prizrenit me rreth 12%, Regjioni i Ferizajt me rreth 10%, Regjioni i Gjilanit me rreth 10%, Regjioni i Mitrovicës me rreth 9%, Regjioni i Pejës me mbi 8%, dhe Regjioni i Gjakovës me rreth 6%.

Numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve sipas aktivitetit

Bazuar në të dhënat e fundit nga administrata tatimore, numri i përgjithshëm i bizneseve në dhjetor 2024 ka arritur shifrën prej 131,791 ndërmarrje aktive.

Në numrin e përgjithshëm të bizneseve aktive sipas numrit të punëtorëve ndahet në Mikro, Të Vogla, Të Mesme dhe Të Mëdha¹, Bizneset Mikro e Të Vogla marrin pjesë me 86.9%, Të Mesme me 9.6% dhe Të Mëdha me 3.5%. Në tabelën në vijim paraqesim numri e bizneseve sipas madhësisë (kriter nr. punëtorëve) dhe aktivitetëve për vitin 2024.

Numri i bizneseve sipas aktivitetit dhe madhësisë	Mikro	Vogla	Mesme	Mëdha	Gjithsej 2024
---	-------	-------	-------	-------	---------------

¹ Kategorizimi i ndërmarrjeve sipas numrit të punëtorëve: Mikro 1 deri 9 punëtor, Të Vogla 10 deri 49 punëtor, Të Mesme 50 deri 249 punëtor, Të Mëdha 250 e mbi punëtor,

Nr.	Përshkrimi i Aktivitetit					
0	Mungon aktiviteti	1,990	291	224	102	2,607
1	Bujqësia; Pylltaria dhe Peshkimi	3,443	512	173	46	4,174
2	Industria nxjerrëse	368	42	66	44	520
3	Industria përpunuese	8,241	3,309	1,704	680	13,934
4	Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	430	23	25	36	514
5	Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave	371	79	32	41	523
6	Ndertimtaria	6,834	2,209	1,481	625	11,149
7	Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	23,363	9,249	4,385	2,034	39,031
8	Transporti dhe magazinimi	3,071	778	478	149	4,476
9	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	7,534	3,155	956	121	11,766
10	Informimi dhe komunikimi	3,965	978	600	173	5,716
11	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	666	217	62	53	998
12	Aktivitetet e patundshmerise	1,052	140	130	33	1,355
13	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	6,421	2,894	929	126	10,370
14	Shërbimet administrative dhe mbështetëse	3,503	1,018	384	141	5,046
15	Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshem	334	52	53	18	457
16	Arsimi	911	485	138	23	1,557
17	Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	1,603	1,344	385	44	3,376
18	Artet, Arëtimi dhe rekreacioni	1,655	486	107	24	2,272
19	Aktivitetet e tjera shërbyese	9,498	1,946	370	66	11,880
20	Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës... Aktivitetet e ekonomive familjare përdorim vetanak	6	-	-	-	6
21	Aktivitetet e trupave dhe organizatave ndërkombetare	59	-	1	4	64
50	Person Fizik	-	-	-	-	-
	TOTALI:	85,318	29,207	12,683	4,583	131,791

Burimi: Administratë Tatimore e Kosovë (ATK)

Në tabelën në vijim paraqesim numri e bizneseve nëpër vite dhe përqindjen si dhe pjesëmarrjen në numrin e përgjithshëm sipas aktiviteteve.

Nr.	Përshkrimi i Aktivitetit	2021		2022		2023		2024	
		në nr.	në %	në nr.	në %	në nr.	në %	në nr.	në%
0	Mungon aktiviteti	1,963	2.0	2,131	2.0	2,326	2.0	2,607	2.0
1	Bujqësia; Pylltaria dhe Peshkimi	3,092	3.1	3,371	3.1	3,713	3.1	4,174	3.2
2	Industria nxjerrëse	452	0.5	477	0.4	499	0.4	520	0.4
3	Industria përpunuese	10,511	10.7	11,555	10.7	12,615	10.6	13,934	10.6
4	Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	259	0.3	343	0.3	434	0.4	514	0.4
5	Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave	421	0.4	448	0.4	484	0.4	523	0.4
6	Ndertimtaria	7,729	7.9	8,775	8.1	9,835	8.3	11,149	8.5

7	Tregtia me shumice dhe pakice; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoeikletave	31,356	31.9	33,605	31.1	36,130	30.3	39,031	29.6
8	Transporti dhe magazinimi	3,640	3.7	3,873	3.6	4,118	3.5	4,476	3.4
9	Akomodimi dhe sherbimi ushqimor	8,864	9.0	9,807	9.1	10,755	9.0	11,766	8.9
10	Informimi dhe komunikimi	3,800	3.9	4,367	4.0	4,990	4.2	5,716	4.3
11	Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	721	0.7	796	0.7	896	0.8	998	0.8
12	Aktivitetet e patundshmerise	860	0.9	1,000	0.9	1,183	1.0	1,355	1.0
13	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	7,111	7.2	8,057	7.4	9,195	7.7	10,370	7.9
14	Sherbimet administrative dhe mbeshtetese	2,922	3.0	3,547	3.3	4,268	3.6	5,046	3.8
15	Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshem	412	0.4	425	0.4	441	0.4	457	0.3
16	Arsimi	1,169	1.2	1,286	1.2	1,430	1.2	1,557	1.2
17	Aktivitetet e shendetit te njeriut dhe te punes sociale	2,523	2.6	2,787	2.6	3,072	2.6	3,376	2.6
18	Artet, Argetimi dhe rekreacioni	1,612	1.6	1,822	1.7	2,012	1.7	2,272	1.7
19	Aktivitetet e tjera sherbyese	8,689	8.9	9,631	8.9	10,725	9.0	11,880	9.0
20	Aktivitetet e ekonomive familjare si punedhenes... Aktivitetet e ekonomive familjare perdorim vetanak	5	0.0	5	0.0	6	0.0	6	0.0
21	Aktivitetet e trupave dhe organizatave nderkombetare	58	0.1	58	0.1	63	0.1	64	0.0
50	Person Fizik	-	0.0	-	0.0	-	0.0	-	0.0
	TOTALI:	98,169	100.0	108,166	100.0	119,190	100.0	131,791	100.0

Burimi: Administrat Tatimore e Kosovë (ATK)

Bazuar në të dhënat për 2024 sipas Aktivitetet ekonomike, nga tabela shihet se kryesisht dominohen nga: Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 29.6% (nën mesatare 2021-2024, 30.7%) nga numri i përgjithshëm i bizneseve aktive; Prodhim me 10.6% (=mesatare 2021-2024, 10.6%), Ndërtimtari me 8.5% (mbi mesatare 2021-2024, 8.2%), Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 7.9% (mbi mesatare 2021-2024, 7.6%), Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 8.9% (nën mesatare 2021-2024, 9.0%), si përqindje të numri i përgjithshëm i bizneseve etj.

Në tabelën në vijim paraqet numri e bizneseve, që kanë deklaruar të paktën një deklaratë² për periudhën përkatëse 2021 deri 2024 dhe përqindja si pjesëmarrjen në numrin e përgjithshëm sipas aktiviteteve.

	Numri i bizneseve sipas aktivitetit dhe madhësisë	2021		2022		2023		2024	
Nr.	Përshkrimi i Aktivitetit	në nr.	në %	në nr.	në %	në nr.	në %	në nr.	në%
0	Mungon aktiviteti	1,483	1.8	1,441	1.7	1,462	1.6	1,366	1.5
1	Bujqësia; Pylltaria dhe Peshkimi	2,779	3.4	2,829	3.3	2,917	3.2	2,970	3.2

² Shënim: numri i përgjithshëm e bizneseve aktive me të paktën një deklaratë në periudha përkatëse është i ndryshueshëm në varësi nga procesi i regjistrimit apo shurjesë së ndërmarrjeve, deklaratat tatimore dhe dinamike aktiviteteve të administratës tatimore.

2	Industria nxjerrëse	323	0.4	333	0.4	331	0.4	327	0.3
3	Industria përpunuese	8,926	10.9	9,490	10.9	9,946	10.9	10,358	11.0
4	Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	199	0.2	264	0.3	322	0.4	345	0.4
5	Furnizimi me uje; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave	280	0.3	285	0.3	294	0.3	299	0.3
6	Ndertimtaria	6,720	8.2	7,354	8.5	7,880	8.6	8,369	8.9
7	Tregtia me shumice dhe pakice; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoeikletave	24,917	30.4	25,889	29.8	26,745	29.3	27,372	29.2
8	Transporti dhe magazinimi	3,248	4.0	3,256	3.7	3,209	3.5	3,198	3.4
9	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	6,697	8.2	7,070	8.1	7,300	8.0	7,406	7.9
10	Informimi dhe komunikimi	3,187	3.9	3,497	4.0	3,831	4.2	4,114	4.4
11	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	601	0.7	623	0.7	682	0.7	692	0.7
12	Aktivitetet e patundshmerise	584	0.7	696	0.8	802	0.9	851	0.9
13	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	6,462	7.9	7,167	8.3	7,895	8.6	8,453	9.0
14	Sherbimet administrative dhe mbështetese	2,533	3.1	2,963	3.4	3,377	3.7	3,663	3.9
15	Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshem	320	0.4	325	0.4	322	0.4	319	0.3
16	Arsimi	1,056	1.3	1,122	1.3	1,199	1.3	1,220	1.3
17	Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	2,435	3.0	2,638	3.0	2,850	3.1	3,009	3.2
18	Artet, Argetimi dhe rekreacioni	1,433	1.7	1,537	1.8	1,608	1.8	1,682	1.8
19	Aktivitetet e tjera shërbyese	7,672	9.4	8,010	9.2	8,268	9.1	7,726	8.2
20	Aktivitetet e ekonomive familjare si punedhenes... Aktivitetet e ekonomive familjare perdorim vetanak	3	0.0	3	0.0	4	0.0	4	0.0
21	Aktivitetet e trupave dhe organizatave nderkombetare	37	0.0	36	0.0	38	0.0	41	0.0
50	Person Fizik	-	0.0	-	0.0	-	0.0	-	0.0
	TOTALI:	81,895	100.0	86,828	100.0	91,282	100.0	93,784	100.0

(*) të dhënat 2021-2024, bazohen në deklaratimet e procesuara deri janar 2025,

Burimi: Administratë Tatimore e Kosovës (ATK)

Aktivitetet e Kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës



Me datë 1 tetor 2024, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, në cilësinë e Kryetarit të Bordit Menaxhues të WB6 CIF, mori pjesë në konferencën e Suppliers Balkan Expo “SUBEX”. Kryetari Rafuna theksoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për rritjen e konkurrencës dhe integrimin e bizneseve në tregjet globale. Ngjarja shërbeu si platformë për shkëmbim përvojash, krijimin e partneriteteve dhe forcimin e rrjetëzimit ekonomik.

Me datë 8 tetor 2024, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, mori pjesë në takim të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, ku u diskutuan sfidat dhe mundësitë për zhvillimin e biznesit vendor.

Oda Ekonomike e Kosovës vazhdon angazhimin për përmirësimin e kushteve të biznesit dhe mbështetjen e sektorëve ekonomikë në vend.



Me datë 10 tetor 2024, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, gjatë vizitës zyrtare në Itali, u takua me Kryetarin e Odës së Tregtisë të Venecias, Antonio Paoletti.

Gjatë takimit, u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit bilateral dhe zhvillimi i projekteve të përbashkëta për të nxitur rritjen ekonomike.

Një ndër temat kryesore ishte edhe nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi mes dy odave, e cila pritet të konkretizohet së shpejti, duke hapur rrugë për lidhje më të forta ekonomike mes bizneseve të të dyja vendeve.



Foto nga takimi

Me datë 11 tetor 2024, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, vizitoi 6 kompani kosovare që po merrnin pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Ndërtimitarisë SAIE në Bolonjë, Itali.

Ky aktivitet u organizua nga Oda Ekonomike e Kosovës me mbështetje nga Western Balkans 6 Chamber Investment Forum.



Kompanitë kosovare, të cilat përfaqësojnë sektorin e ndërtimitarisë, patën mundësinë të prezantojnë produktet dhe shërbimet e tyre në një nga panairot më të rëndësishme në Evropë.

Të gjitha shpenzimet për shtand, transport dhe akomodim u mbuluan nga OEK. Kompanitë pjesëmarrëse ishin: B.Bavaria, Eurometal, Tiki Design, Regina Colori, Proton Cable dhe Pozhegu Brothers.

Foto nga vizita në SAIE



Me datë 15 tetor 2024, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, përfaqësoi Kosovën në Samitin Biznesor Evropë-Azi, të organizuar nga Federata Botërore e Odave Ekonomike.

Ky samit prestigjioz mbledh liderë të biznesit dhe Kryetarë të Odave Ekonomike nga Evropa dhe Azia për të diskutuar mundësitë e bashkëpunimit ekonomik, inovacionit dhe partneriteteve tregtare.

Kosova ishte krenare që ishte pjesë e këtij dialogu global, duke punuar për të forcuar lidhjet ndërkombëtare të biznesit. Samiti u mbajt në Stamboll, Turqi.



Foto nga Samiti Biznesor Evropë-Azi



Me datë 15 tetor 2024, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, përfaqësoi bizneset kosovare në takimin e Komitetit të Eurochambres në Stamboll.

Diskutimet u përqendruan në marrëdhëniet e BE-së me vendet jo-anëtare, zgjerimin e BE-së dhe perspektivën e biznesit.

Kryetari Rafuna gjithashtu informoi anëtarët për aktivitetet në Kosovë dhe rajonin e Ballkanit, lidhur me Procesin e Berlinit. Oda Ekonomike e Kosovës vazhdon të mbrojë interesat e komunitetit të biznesit të Kosovës në mekanizmat evropianë.



Foto nga takimi

Me datë 16 tetor 2024, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, u takua me Philippe Varin, Presidentin e Odës Ndërkombëtare të Ekonomisë (ICC) gjatë një vizite në Stamboll.

Oda Ekonomike e Kosovës vazhdon të jetë e angazhuar për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përkrah zhvillimin e marrëdhënieve me organizata globale si ICC.

Kryetari Rafuna theksoi rëndësinë e këtij partneriteti dhe shprehu dëshirën për të mirëpritur së shpejti z. Varin dhe udhëheqësin e ICC-së në Kosovë, me qëllim të forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit dhe eksplorimit të mundësive të reja për zhvillimin e biznesit.

Me datë 18 tetor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës mirëpriti përfaqësuesit e "Eastern Black Sea Exporters Association" nga Turqia për të diskutuar mundësitë e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar ndërmjet Kosovës dhe Turqisë.



Foto nga takimi

Me datë 21 tetor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës organizoi me sukses Panairin Agri-Renew 2024 në Prishtina Mall, një ngjarje e rëndësishme që bashkoi biznese dhe profesionistë nga sektori i bujqësisë dhe energjisë së ripërtërishme.

Gjatë tre ditëve të panairit, u ofruan mundësi për bashkëpunim dhe zhvillim të partneriteteve të reja përmes takimeve B2B dhe prezantimeve të risive teknologjike dhe inovative në këto fusha.

Ky panair tregoi rëndësinë e tij si një platformë kyçe për promovimin e zhvillimit ekonomik dhe mbështetje të sektorëve strategjikë si bujqësia dhe energjia e ripërtërishme, duke kontribuar në forcimin e lidhjeve ndërkombëtare.




Foto nga Panairi "Agri-Renew 2024"

Me datë 23 tetor 2024, Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga Shefi i Stafit të Kryeministrit, Luan Dalipi, mirëpriti Vladimír Dlouhý, Presidentin e Eurochambres, dhe Kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna.

Gjatë takimit, u diskutua për rëndësinë e krijimit të kushteve më të favorshme për të bërit biznes, ofertat e Kosovës për investitorët e huaj dhe përshejtimin e zhvillimit ekonomik të vendit përmes investimeve të përbashkëta dhe inovacionit.

Eurochambres, që përfaqëson mbi 20 milionë biznese nëpërmjet 1700 odave ekonomike anëtare, është një partner i rëndësishëm për Odën Ekonomike të Kosovës, e cila është anëtare e kësaj organizate.



Foto nga takimi me Kryeministrin e Republikës së Kosovës

Me datë 23 tetor 2024, Ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav, priti në takim Presidentin e Eurochambres, Vladimír Dlouhý, dhe Kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna.



Takimi u fokusua në thellimin e bashkëpunimit ekonomik mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian, me qëllim krijimin e mundësive të reja për bizneset kosovare dhe përmirësimin e qasjes së tyre në tregjet evropiane.

Foto nga takimi me Ambasadorin e Bashkimit Evropian në Kosovë

Më 23 tetor 2024, Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, priti përfaqësuesit e Eurochambres, Vladimír Dlouhý dhe Ben Butters, si dhe Kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna.

Ata diskutuan për rëndësinë e krijimit të kushteve të favorshme për biznes dhe rritjen e bashkëpunimit mes institucioneve të Kosovës dhe Eurochambres për të stimuluar investimet dhe zhvillimin ekonomik. Përfaqësuesit e Eurochambres shprehën gatishmërinë për të mbështetur rritjen e investimeve nga bizneset evropiane në Kosovë.



Foto nga takimi me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës

Më 24 tetor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës mirëpriti Presidentin e Eurochambres në një vizitë të rëndësishme. Takimi theksoi lidhjet e forta ndërmjet Kosovës dhe komunitetit të biznesit evropian, duke hapur mundësi për bashkëpunim dhe rritje.



Foto nga takimi me Presidentin e Eurochambres

Diskutimet u përqendruan në përmirësimin e marrëdhënieve tregtare, promovimin e mundësive për investime dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet bizneseve kosovare dhe atyre evropiane. Kjo vizitë shënoi një hap të rëndësishëm për forcimin e pozitës së Kosovës në ekonominë evropiane.

Më 24 tetor 2024, në Tiranë u mbajt një takim i rëndësishëm ku u diskutua për rolin e Odave të Tregtisë në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe lidhjen e bizneseve të Shqipërisë dhe rajonit me tregun Evropian.



Foto nga takimi i zhvilluar në Shqipëri

Takimi përfshiu Kryetarin e OEK, Lulzim Rafuna, në cilësinë e Kryetarit të Bordit Menaxhues të WB6 CIF, Ines Muçostepa, Presidente e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, si dhe përfaqësues të tjerë nga Shqipëria dhe Eurochambres.

Diskutimet përqendruan zhvillimin e mundësive për investime dhe përmirësimin e marrëdhënieve tregtare.

Më 29 tetor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës, e udhëhequr nga Kryetari Lulzim Rafuna, zhvilloi një takim me Shefen e Misionit të IOM-it në Kosovë, Anna Rostocka, për të diskutuar mbi mundësitë e bashkëpunimit në fushën e migrimit dhe mobilitetit të punëtorëve. Ky bashkëpunim do të përfshijë një studim mbi nevojat dhe sfidat që lidhen me mobilitetin, si dhe nevojat e sektorit privat.



Foto nga takimi me Shefen e Misionit të IOM-it në Kosovë

Më 6 nëntor 2024, Kryetari Lulzim Rafuna takoi Këshillin Rajonal të OEK në Prizren, ku informoi bizneset mbi aktivitetet dhe progresin e Odës Ekonomike të Kosovës gjatë vitit 2024. Gjatë takimit, u diskutuan sfidat me të cilat po përballen bizneset në këtë rajon dhe u dakordua që kërkesat e tyre të adresohen në institucionet relevante. OEK falënderoi anëtarët për mbështetjen e vazhdueshme dhe bashkëpunimin në çdo aktivitet.



Foto nga takimi me Këshillin Rajonal të OEK në Prizren

Më 8 nëntor 2024, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, dhe Drejtori Ekzekutiv i Odës Amerikane në Kosovë, z. Arian Zeka, pritën në takim misionin e FMN-së. Gjatë takimit u diskutua për sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e ambientit të të bërit biznes në Kosovë.



Foto nga takimi me përfaqësuesit e FMN-së

Më 18 nëntor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës, me ndërmjetësim të Ambasadës së Kosovës në Emiratet e Bashkuara, nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi (MoU) me Odën Ekonomike të Dubait për të forcuar marrëdhëniet dypalëshe të biznesit.

Marrëveshja, e nënshkruar nga Kryetari i Odës Ekonomike të Dubait, z. Mohammad Ali Rashed Lootah, dhe Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, synon të rrisë tregtinë, investimet dhe partneritetet strategjike mes dy rajoneve.



Kryetari Rafuna theksoi rëndësinë e këtij partneriteti për mundësitë e zhvillimit të bizneseve në tregjet globale, ndërsa Kryetari Lootah theksoi përkushtimin e Dubait për zgjerimin e lidhjeve me tregjet në zhvillim, si Kosova.

Foto nga takimi dhe nënshkrimi i MoU



Më 20 nëntor 2024, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, vizitoi Ambasadën e Kosovës në Katar, ku u prit nga Ambasadori Fuad Morina.

Gjatë takimit, u diskutuan mundësitë për tërheqjen e investimeve nga Katari, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit për të ndihmuar në investimin e bizneseve të Katarit në Kosovë dhe përkrahjen e bizneseve kosovare në gjetjen e partnerëve në Katar.

Oda Ekonomike e Kosovës theksoi përkushtimin e saj për të krijuar një mjedis të favorshëm për investitorët ndërkombëtarë, duke promovuar mundësi për rritje të investimeve.

Më 20 nëntor 2024, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, takoi biznesmenin kosovar, z. Dijamant Asllani, pronarin e Proper Pizza, që ka hapur 6 pika në Katar dhe planifikon zgjerim në Arabinë Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe.

Ky sukses tregon potencialin e bizneseve kosovare për të konkurruar në tregje ndërkombëtare. Oda Ekonomike e Kosovës vazhdon të mbështesë bizneset që synojnë zgjerimin global.



Foto nga vizita dhe takimi në Proper Pizza në Katar



Më 21 nëntor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës dhe Oda Ekonomike e Katarit nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi në Doha, duke forcuar lidhjet ekonomike, tregtare dhe investuese mes dy vendeve.

Marrëveshja u nënshkrua nga Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, dhe Nënkrjetari i Odës Ekonomike të Katarit, z. Rashid Hamad Al-Athbah.

Ky hap simbolizon një fazë të re bashkëpunimi, duke theksuar zhvillimin ekonomik dhe mundësitë për investime.



Foto nga takimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit

Më 22 nëntor 2024, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, vizitoi Invest Qatar në Doha pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Odën Ekonomike e Katarit.



Foto nga vizita në Invest Qatar

Gjatë takimit, u diskutua për forcuar lidhjet ekonomike dhe për promovimin e Kosovës si një destinacion atraktiv për investitorët nga Katari.

Ky bashkëpunim synon të krijojë mundësi për zhvillimin ekonomik dhe të mbështesë sektorë kyç si energjia, teknologjia, bujqësia dhe turizmi. Kryetari Rafuna shprehu besimin se partneriteti do të sjellë përfitime të ndërsjella për të dy vendet.

Më 26 nëntor 2024, Kryetari Rafuna, priti në takim Kryetarin e Odës Ekonomike të Nepalit. Ky takim shënoi një hap të rëndësishëm drejt thellimit të bashkëpunimit ekonomik dhe eksplorimit të mundësive për bashkëpunim mes dy vendeve.

Gjatë takimit, palët diskutuan fushat me interes të ndërsjellë, duke përfshirë tregtinë, investimet dhe inovacionin, si dhe ndanë njohuri dhe praktika më të mira për fuqizimin e bizneseve dhe krijimin e mundësive të reja për rritje dhe zhvillim në të dyja vendet.

Kryetari Rafuna theksoi rëndësinë e forcimit të lidhjeve mes Kosovës dhe Nepalit dhe u shpreh se kjo mund të sjellë përfitime të ndërsjella për të dyja ekonomitë.



Foto nga takimi

Me datë 27 nëntor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës, e udhëhequr nga Kryetari Rafuna, dhe Federata e Futbollit të Kosovës e udhëhequr nga Kryetari Agim Ademi, nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi.

Ky bashkëpunim ka për qëllim të promovojë sportin, mbështesë zhvillimin ekonomik dhe forcojë prezencën ndërkombëtare të Kosovës, duke nxitur sponsorizimet, mbështetur politikat mbështetëse dhe për të ndërtuar kapacitete për përfitime të ndërsjella. Bashkë do të krijojnë mundësi të reja që do të lidhin sektorët e sportit dhe biznesit për zhvillimin e Kosovës.




Foto nga takimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes

Me datë 27 nëntor 2024, investitori italian Flavio Boccia nga "Flavio Boccia & Partners", me mbështetje nga Eurometal, u takua me Kryetarin Rafuna, për të diskutuar mundësitë e investimeve dhe zhvillimin e prodhimeve të reja në Kosovë.

Kryetari Rafuna theksoi gatishmërinë për mbështetje të plotë për investitorët italianë, duke krijuar një mjedis të favorshëm për investimet dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe investitorëve ndërkombëtarë.



Foto nga takimi

Më 29 nëntor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës u përzgjodh si përfituese e grantit nga USAID Kosovo Compete Activity për aktivitetin e saj të propozuar, "Podcasti i Odës Ekonomike të Kosovës: Fuqizimi i Rritjes Ekonomike dhe Investimeve".

Ky podcast do të përdorë diskutime me ekspertë, zyrtarë qeveritarë dhe liderë të biznesit për të promovuar sektorët kyç, tërhequr investime të huaja dhe ofruar një platformë për diskutime mbi tema të rëndësishme ekonomike.



Foto nga takimi dhe nënshkrimi i Grantit

Më 3 dhjetor 2024, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, dhe Dekani i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, Prof. Dr. Driton Balaj, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit për lidhjen e arsimit me sektorin privat.



Foto nga takimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit

Marrëveshja përfshin krijimin e një qendre për studentët, që do t'u ofrojë mundësi për zhvillimin e ideve inovative dhe mundësi punësimi në industrinë private.

Bashkëpunimi gjithashtu do t'u mundësojë studentëve të prezantojnë idetë e tyre në tregjet ndërkombëtare përmes rrjetëzimit të OEK me Odat Ekonomike Ndërkombëtare.



Foto nga takimi dhe nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit

Më 5 dhjetor 2024, në ambientet e Odës Ekonomike të Kosovës, u prezantuan rezultatet e hulumtimit mbi mungesën e fuqisë punëtore në sektorët kryesorë ekonomikë të Kosovës dhe nevojat për fuqinë punëtore të huaj, projekt ky i mbështetur nga IOM Kosova.

Gjatë këtij eventi, Oda Ekonomike e Kosovës dhe IOM Kosova nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt forcimit dhe zgjerimit të aktiviteteve të përbashkëta.



Foto nga Gala Mbrëmja "The Best of Kosova 2024"

Më 6 dhjetor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës ka organizuar Gala Mbrëmjen "The Best of Kosova 2024", një ngjarje e veçantë që ka shpërndarë çmimet për kompanitë që kanë pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në vitin 2024.

Gjatë këtij eventit prestigjioz, janë shpërndarë çmimet për tatimpaguesit, eksportuesit dhe punëdhënësit më të suksesshëm, duke njohur kontributet e tyre të rëndësishme në zhvillimin e ekonomisë kosovare.

Po ashtu, janë shpërndarë çmime në disa kategori të tjera të rëndësishme, si "The Best Ambassador of Made in Kosova Brand", "Nxitja e Investimeve të Diasporës në Kosovë", dhe "Initiator of the Support of the Circular Economy".

Ky eveniment ka shënuar një ditë të paharrueshme për ata që kanë kontribuar në zhvillimin e ekonomisë dhe kanë dhënë shembuj të jashtëzakonshëm të suksesit.



Më 9 dhjetor 2024, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, priti në takim z. Nedjeljko Spilek, në Ambasadën Kroate.

Gjatë këtij takimi, ata diskutuan për krijimin e një Këshilli të biznesit ndërmjet dy gjuhëve dhe mundësitë për zhvillimin e projekteve të përbashkëta ndërmjet Odave.

Ky takim ka hapur mundësi të reja për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillimin e lidhjeve të forta mes komunitetit të biznesit të Kosovës dhe atij kroat.

Foto nga takimi

Më 12 dhjetor 2024, Kryetari Rafuna, nënshkroi deklaratën e objektivave të përbashkëta për themelimin e “Dhomës Ekonomike Bilaterale Shqipëri–Kosovë”.

Kryetarja e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, znj. Ines Muçostepa, u prit nga Kryetari Rafuna dhe Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, z. Petrit Malaj, në një takim zyrtar për të diskutuar hapat e ardhshëm për realizimin e kësaj deklaratë.



Palët ranë dakord për të finalizuar detajet e funksionalizimit të “Dhomës Ekonomike Bilaterale Shqipëri-Kosovë,” e cila ka për qëllim të rrisë bashkëpunimin ekonomik dhe strategjik ndërmjet dy vendeve.

Kjo Dhomë do të përfaqësojë interesat e biznesit të të dyja vendeve dhe do të adresojë shqetësimet e komunitetit të biznesit, duke i propozuar qeverive përkatëse, në përputhje me objektivat e Deklaratës të nënshkruar më 26 nëntor 2018 në Pejë, gjatë mbledhjes së dy qeverive.

Foto nga takimi dhe nënshkrimi i Deklaratës së Përbashkët

Më 13 dhjetor 2024, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, mori pjesë në konferencën vjetore "Sistemi Shëndetësor 2024", organizuar nga Shoqata e Spitaleve Private.

Në fjalimin e tij, Kryetari Rafuna theksoi angazhimin e Odës Ekonomike të Kosovës për krijimin e një sistemi që garanton qasje të barabartë për qytetarët dhe mbështet zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm përmes shëndetit dhe mirëqenies së punonjësve.

Ai theksoi angazhimin e dy Shoqatave kryesore, atë të Spitaleve Private dhe Farmaceutikës, për promovimin e inovacionit dhe bashkëpunimit, si dhe procesin e themelimit të Shoqatës së Sigurimeve, që do të mbështesë implementimin e sistemeve të sigurimit të punonjësve në Kosovë.



Foto nga Konferenca

Më 17 dhjetor 2024, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, gjithashtu Kryesues i Bordit Drejtues të WB6-CIF, mori pjesë në takim të 33-të të Bordit Drejtues të Forumit Investiv të 6 Odave të Ballkanit Perëndimor.



Foto nga takimi i Bordit Drejtues WB6-CIF

Më 18 dhjetor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës mbajti takimin e Këshillit Drejtues dhe Kuvendit të OEK-ut, ku u diskutua mbi punën e realizuar dhe sfidat e vitit 2024.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, theksoi se ky vit ka qenë jashtëzakonisht dinamik për OEK-un, duke pasur sukses në shumë fusha, por gjithashtu edhe sfida të shumta me të cilat është përballur OEK gjatë kësaj periudhe. Ai theksoi angazhimin dhe përkushtimin e vazhdueshëm të OEK-ut për të mbështetur zhvillimin e ekonomisë së Kosovës dhe për të adresuar nevojat e komunitetit të biznesit.

Gjatë takimit, u diskutua për planet dhe strategjitë për vitin 2025, duke u angazhuar për të forcuar pozitën dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të Odës Ekonomike të Kosovës.



Foto nga takimi i Këshillit Drejtues dhe Kuvendit



Më 19 Dhjetor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës, në bashkëpunim me Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare, nënshkruan një Marrëveshje të Mirëkuptimit për themelimin e Zyrës së Diasporës Mbarëkombëtare.

Ky hap i rëndësishëm synon të forcojë lidhjet ekonomike dhe të promovojë investimet mes shqiptarëve të diasporës dhe atdheut. Zyra do të ofrojë mbështetje për shqiptarët jashtë vendit, duke u mundësuar atyre të kontribuojnë më shumë në zhvillimin e ekonomisë kombëtare. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, theksoi rëndësinë e këtij projekti për forcimin e komunitetit ekonomik shqiptar global.

Me datë 20 Dhjetor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me Rrjetin Global të Bizneseve Shqiptare të Diasporës.

Ky bashkëpunim synon të krijojë një platformë për mbështetje të bizneseve shqiptare në Diasporë dhe në Kosovë, duke ofruar mundësi për shkëmbime të njohurive, investime dhe forcimin e bashkëpunimit ekonomik.

Marrëveshja hap mundësi për zhvillimin e projekteve të përbashkëta dhe rritjen e lidhjeve mes bizneseve kosovare dhe atyre të diasporës. Ky është një hap i rëndësishëm në integrimin ekonomik të Kosovës dhe promovimin e mundësive për sipërmarrësit shqiptarë.



Foto nga takimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit

Aktivitetet e tjera të Odës Ekonomike të Kosovës

Më 17 tetor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës filloi trajnimin "Projekti Investiv - Hartimi i Planit të Biznesit".

Trajnimi mbledhi profesionistë të fushave të ndryshme, të cilët u informuan mbi modulet dhe aktivitetet që do të zhvillohen gjatë këtij procesi. Pjesëmarrësit zhvilluan aftësinë për të hartuar një plan investiv dhe për të aplikuar saktësisht për projekte.



Foto nga trajnimi


Më 21 tetor 2024, në kuadër të panairit "AgriRenew 2024", Oda Ekonomike e Kosovës organizoi Konferencën Kombëtare mbi Nxitjen e Ekonomisë Qarkore në Kosovë.

Ky event bashkoi përfaqësues nga ministritë, liderë të industrisë, organizata donatore ndërkombëtare dhe institucione financiare.

Gjatë konferencës, u diskutuan nevojat dhe sfidat e Kosovës në kalimin në një ekonomi qarkore dhe të qëndrueshme, si dhe mundësitë për mbështetje teknike dhe financiare për projektet e gjelbra nga sektori privat dhe organizatat ndërkombëtare.



Foto nga Konferenca



Më 22 tetor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës, në kuadër të Panairit Agri-Renew dhe me mbështetjen e GIZ, organizoi aktivitetin inovativ "CV Corner" dhe "Orientimi në Karrierë" për katër shkolla të mesme profesionale.

Ky aktivitet kishte për qëllim të ndihmonte të rinjtë në zhvillimin e shkathtësive dhe orientimin e tyre drejt tregut të punës.

Nxënësit patën mundësinë të merrnin informacione dhe këshilla mbi mësimin dual, shkathtësitë e kërkuara për tregun e punës, inovacionin dhe ndërmarrësinë. Aktiviteti u mundësoi nxënësve të lidheshin me ekspertë dhe të përgatiteshin më mirë për mundësitë e karrierës së ardhshme.

Oda Ekonomike e Kosovës, së bashku me Odat e Ballkanit Perëndimor dhe Institutin e Vjenës, ka publikuar studimin mbi ndikimin e nearshoring dhe dekarbonizimit në rajon.



Studimi sugjeron rritjen e investimeve në teknologji të gjelbra dhe mbështetje për kompanitë që po dekarbonizohen.

Ai gjithashtu ofron rekomandime për investitorët dhe kompanitë lokale për të përmbushur standardet globale dhe për të rritur konkurrencën në rajon përmes përpjekjeve për qëndrueshmëri.

Linku i studimit:

https://www.wb6cif.eu/.../2024/09/Report_2024_v3_web.pdf

Oda Ekonomike e Kosovës ka identifikuar 165 kompani të gatshme të përfshihen në sistemin dual për vitin shkollor 2024/25, duke ofruar mundësi për 1120 nxënës në 12 profile pilot. Po ashtu, 160 nxënës do të sistemohen në 4 profile të energjisë së ripërtëritshme për vitin shkollor 2025/26. Ky program ofron mundësi për kompanitë të investojnë në zhvillimin e shkathtësive të rinjve, për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës.



Kompanitë që duan të angazhohen mund të plotësojnë formularin këtu: [Formulari](#).

Më 1 Nëntor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës ka përfunduar me sukses trajnimin “Zhvillimi i Burimeve Njerëzore”.

Gjatë këtij trajnimi, pjesëmarrësit kishin mundësinë të mësojnë mbi praktikat më të mira në zhvillimin e talentit, motivimin e ekipeve, menaxhimin e performancës dhe krijimin e një mjedisi pune që nxit zhvillimin profesional. Ky trajnim ka kontribuar në forcimin e aftësive dhe njohurive të pjesëmarrësve, që do të ndikojnë pozitivisht në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së punës në të ardhmen.



Foto nga trajnimi

Më 22 Nëntor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës ka përfunduar me sukses Trajnimin Profesional për Forex për Grupin 6.

Gjatë këtij programi, pjesëmarrësit kishin mundësinë të trajnohen nga bazat deri në nivele më të avancuara, duke përvetësuar strategjitë e nevojshme për t'u bërë tregtarë të suksesshëm.



Foto nga trajnimi

Më 25 Nëntor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës organizoi MULTIPLY EVENT-in e dytë, një iniciativë kyçe për të nxitur mobilitetin në Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP). Ky projekt ka si synim krijimin e mundësive për mobilitetin në fushën e AAP-së, me fokus të veçantë në sektorin e hotelerisë dhe turizmit, duke lidhur institucione nga vendet e BE-së dhe Ballkani Perëndimor, përfshirë Kosovën.



Foto nga MULTIPLY EVENT

Më 4 dhjetor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës dhe GIZ organizuan një workshop me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të sektorëve të tregtisë me pakicë dhe riciklimit/ekonomisë së gjelbër.

Takimi kishte për qëllim diskutimin dhe mbledhjen e ideve nga bizneset për zhvillimin e profileve të reja të Arsimit Dual, duke u fokusuar në nevojat reale të tregut dhe sektorit privat.

Bashkëpunimi mes bizneseve, MASHTI, OEK dhe GIZ është thelbësor për të ndërtuar një të ardhme më të qëndrueshme dhe për të përgatitur gjeneratat e reja për sfidat e ekonomisë moderne.



Foto nga Workshop-i



Më 4 dhjetor 2024, është mbajtur me sukses trajnimi mbi temën "Vlerësimi i Dëmeve Natyrore në Toka dhe Kultura Bujqësore".

Ky trajnim ofroi mundësinë për ndarjen e njohurive të nevojshme për të punuar dhe forcuar kapacitetet për përballimin më të mirë të sfidave që lidhen me ndikimin e shëndetit në sektorin e bujqësisë.

Foto nga trajnimi

Më 9 dhjetor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës, në bashkëpunim me WB6 CIF dhe mbështetjen e Komisionit Evropian, ka përfunduar me sukses trajnimin online mbi temën "CE MARKING" për bizneset kosovare.

Ky trajnim ofroi njohuri mbi kërkesat teknike dhe rregulloret evropiane, udhëzime praktike për përdorimin e platformës së CE Marking, si dhe hapat për arritjen dhe implementimin e certifikimit CE në bizneset kosovare. Ishte një mundësi e shkëlqyer për bizneset që të avancojnë dhe përshtaten me standardet evropiane.




Foto nga trajnimi online



Më 11 dhjetor 2024, Oda Ekonomike e Kosovës organizoi me sukses trajnimin profesional mbi Përgatitjen e Pasqyrave Financiare.

Ky trajnim theksoi rëndësinë e pasqyrave financiare për transparencën dhe suksesin e çdo organizate.

Foto nga trajnimi



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Oda Ekonomike e Kosovës

Email: info@oek-kcc.org

Web: www.oek-kcc.org